



Fushata e palëve të treta (jo-konkurrente) – krahasime dhe rekomandime për Maqedoninë e Veriut

Shkurt 2026



International Foundation
for Electoral Systems

Ky produkt u përgatit në kuadër të projektit Institucione të Qëndrueshme të Ballkanit për Qeverisje Demokratike dhe Zgjedhje (BRIDGE), i financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar me mbështetjen e Ambasadës Britanike në Shkup dhe Programit për Mbështetjen e Zgjedhjeve të Bashkëpunimit Zviceran në Maqedoninë e Veriut, i zbatuar nga Fondacioni Ndërkombëtar për Sisteme Zgjedhore (IFES). Përmbajtja e këtij produkti nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e donatorëve, projekteve ose zbatuesit/zbatuesve.

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	i
Hyrje	1
Standardet mbi fushatën jo-konkurrente në Evropë	3
Përvojat krahasimtare.....	5
Mbretëria e Bashkuar	7
Irlanda.....	8
Mali i Zi	10
Çështje për t'u marrë në konsideratë në rregullimin e fushatave jo-konkurrente	12
Koordinimi ndërmjet jo-konkurrentëve dhe konkurrentëve.....	12
Rekomandimet për Maqedoninë e Veriut	14
Rekomandime për partitë politike	17
Referencat	18

Përmbledhje ekzekutive

Përderisa fushatat e kaluara zgjedhore shpesh përqendroheshin në tubime të mëdha të organizuara nga partitë politike ose në pankarta dhe postera të paguara nga kandidatët, fushatat aktuale shpesh mbështeten më shumë në publikimet në rrjetet sociale dhe në reklamat onlajn. Gjithnjë e më tepër fushatat e këtilla nuk po realizohen vetëm nga partitë e regjistruara politike ose nga të nominuarit të cilët garojnë si kandidatë, por edhe nga aktorë të tjerë të cilët mund të luajnë një rol të rëndësishëm në rezultatet e zgjedhjeve, shpesh duke pasur shumë pak informacion rreth përfshirjes së tyre.

Ky raport analizon rregullimin e fushatave zgjedhore nga aktorë të tjerë që nuk janë parti politike ose kandidatë, të cilat këtu referohen si **“fushatë jo-konkurrente”**, dhe në të kaluarën shpesh referoheshin si **“fushatë e palëve të treta”**. Shqyrtohen pikëpamje të ndryshme për rregullimin e fushatave jo-konkurrente, si dhe shqyrtohen standardet e kufizuara ekzistuese dhe përvojat praktike të këtij rregullimi. Fokus i veçantë i jepet Irlandës dhe Mbretërisë së Bashkuar, ku fushatat jo-konkurrente rregullohen mbi 20 vjet dhe Malit të Zi – vendi i parë në Ballkanin Perëndimor që rregulloi këtë çështje (në v. 2025).

Duke u bazuar në përvojën ndërkombëtare dhe praktikën e mira, ofrohen rekomandime për rregullimin e fushatave jo-konkurrente në Maqedoninë e Veriut. Në përmbledhje, këto rekomandime janë:

- Të vlerësohen praktikën e kaluara dhe ato të pritshme të fushatës në Maqedoninë e Veriut, në mënyrë që reformat të bazohen në prova dhe t’u përgjigjen nevojave reale
- Të shqyrtohen dispozitat ligjore, që të përfshijnë (të paktën):
 - *Një përkufizim të qartë se çfarë përbën fushata jokonkurrente*
 - *Kërkesë për regjistrimin e jo-konkurrentëve*
 - *Rregullim të qartë të reklamimit politik nga jo-konkurrentët*
 - *Kërkesë që të gjitha reklamimet politike të përmbajnë shënimin se kush i ka financuar*
 - *Kufizime për donacionet dhe shpenzimet*
 - *Raportim financiar*
- Të gjitha rregullimet duhet të shmangin me kujdes kufizimet e panevojshme ndaj lirisë së fjalës dhe efektin frikësues ndaj angazhimit të shoqërisë civile në fushatat zgjedhore
- Të gjitha rregullimet duhet të marrin parasysh koordinimin ndërmjet konkurrentëve dhe jo-konkurrentëve, për të shmangur përdorimin e këtyre të fundit si mënyrë për të anashkaluar rregullat mbi financimin politik.
- Duke pasur parasysh se fushatat jo-konkurrente shpesh përfshijnë reklama onlajn dhe aktivitete që zhvillohen jashtë Maqedonisë së Veriut, por që megjithatë ndikojnë në opinionin e zgjedhësve në vend, duhet të shqyrtohet se në ç’mënyrë mund të rregullohet në mënyrë efektive çdo aktivitet i tillë i zhvilluar jashtë territorit të vendit.
- Kuvendi duhet të përcaktojë qartë se si do të monitorohet respektimi i rregullave për fushatat jo-konkurrente; cili institucion është më i përshtatshmi për mbikëqyrje dhe cilat mekanizma bashkëpunimi ndër-institucional janë të nevojshëm për zbatim efektiv.
- Institucionet mbikëqyrëse në Maqedoninë e Veriut duhet të shqyrtojnë se si monitorimi i fushatave jo-konkurrente mund t’u shtojë vlerë përpjekjeve të tyre aktuale të monitorimit dhe t’i bëjnë rekomandime Kuvendit, duke përfshirë edhe rregullimet institucionale.

- Partitë politike në Maqedoninë e Veriut duhet të mbështesin diskutimet mbi rregullimin e fushatave jo-konkurrense, pasi kjo mund të ndihmojë në forcimin e besimit publik në procesin politik. Ato duhet të sigurojnë në mënyrë proaktive se çdo subjekt që bën fushatë në mbështetje të partisë së tyre të jetë transparent për financat e tij, edhe nëse kërkesa ligjore për këtë ende nuk është vendosur.

Hyrje

Vendet në mbarë botën, dhe veçanërisht vendet evropiane, gjatë dekadave të fundit kanë futur gradualisht rregullime mbi mënyrën se si partitë politike dhe kandidatët zgjedhorë lejohen të mbledhin dhe të shpenzojnë para, si dhe mbi mënyrat për të siguruar transparencë dhe llogaridhënie në financat e tyre.

Megjithatë, vetëm pak vende kanë miratuar rregullime që adresojnë aktivitetet financiare të subjekteve që nuk janë parti politike apo kandidatë (“konkurrent”), por që zhvillojnë aktivitete me qëllim ndikimin e vullnetit zgjedhor të trupit elektoral. Ka dy arsye kryesore pse mungesa e rregullimit të fushatave jo-konkurrente mund të jetë problematike nga perspektiva e integritetit të financimit politik. E para është se konkurrentët mund të bëjnë fushatë përmes jo-konkurrentëve si mënyrë për të anashkaluar rregullat ekzistuese mbi financimin e partive politike dhe fushatave, duke minuar kështu efektivitetin e këtyre rregullave. E dyta është se shpenzimi i shumave të mëdha të parave nga aktorë që nuk i nënshtrohen rregullave të raportimit financiar mund të reduktojë ndjeshëm transparencën mbi mënyrën se si financohet procesi politik, duke fshehur në mënyrë efektive aktivitete si ndërhyrja financiare e huaj dhe korrupsioni politik nga interesa të pasura. Forcimi i qëndrueshmërisë ndaj ndërhyrjeve armiqësore dhe ndikimeve keqdashëse, si nga aktorë vendas ashtu edhe nga ata të huaj, është thelbësor për përmirësimin e kuadrove dhe praktikave për procese zgjedhore dhe qeverisëse të besueshme, transparente dhe të sigurta.

Çështja e fushatave jo-konkurrente ka marrë vëmendje të madhe gjatë dekadës së fundit. Pas vendeve që nxorën rregulla mbi këtë çështje rreth fillimit të mijëvjeçarit (p.sh. Irlanda dhe Mbretëria e Bashkuar), vende si Gjermania, Mali i Zi dhe Zvicra kanë vendosur rregullime për fushatat jo-konkurrente gjatë pesë viteve të fundit. Çështja u trajtua gjithashtu për herë të parë në një dokument standardesh të Kombeve të Bashkuara në fund të vitit 2025.¹ Arsyet për këtë rritje të

Pse “fushatë jokonkurrente” dhe jo “e palëve të treta”?

Termi “palë të treta” është përdorur për të përshkruar përfshirjen e aktorëve që nuk janë parti politike ose kandidatë në fushatat zgjedhore.

Fatkeqësisht, krijohet konfuzion pasi “palë të treta” përdoret gjithashtu për t’iu referuar aktorëve të tjerë, si:

- Ata që bëjnë donacione në emër të dikujt tjetër
- Ata që mbledhin fonde veçmas përpara se t’u japin burime partive politike ose kandidatëve
- Subjekte që janë ligjërisht të lidhura me partitë politike (si forumet e grave ose think tank-et
- Subjekte që shesin hapësirë reklamuese për partitë politike ose kandidatët

Si ilustrim, termi “palë e tretë” përdoret në vlerësimet shtetërore të Grupet e Shteteve Kundër Korrupsionit (GRECO) me kuptime të ndryshme (GRECO, 2026). Edhe më problematike është se përdorimi i termit “palë e tretë” në nenin 84-b.5 të Kodit Zgjedhor të Maqedonisë është i paqartë, ndërsa referenca ndaj “të dhënave të palëve të treta” në nenin 85-b.6 nuk i referohet subjekteve që bëjnë fushatë pa qenë konkurrentë të regjistruar në zgjedhje.

Meqenëse termi “palë e tretë” përdoret për të nënkuptuar shumë gjëra që shkaktojnë konfuzion, janë kërkuar zgjidhje alternative. Duke u bazuar në konceptin e “fushatës jopartiake”, e cila u fut në legjislationin e Mbretërisë së Bashkuar nëpërmjet reformave të vitit 2014, termat “fushatë jokonkurrente” dhe “fushatë jogaruese” kanë filluar të përdoren gjithnjë e më shumë, pasi fokusohen më qartë në çështjet specifike që trajtohen.

¹ UNCAC (2025). Shih më tej f. 3.

vëmendjes janë me gjasë të shumta, megjithatë rritja e përdorimit të rrjeteve sociale për fushatat duket se ka qenë një faktor kryesor.

Në Maqedoninë e Veriut, aktualisht nuk ekzistojnë rregullime për fushatat jo-konkurrente. Megjithatë, kanë nisur diskutime mbi mënyrën se si kjo çështje mund të trajtohet në legjislacion. Ky raport është hartuar për të orientuar këto diskutime, duke u mbështetur në përvojat e vendeve të tjera, si dhe në standardet ekzistuese dhe konsideratat e përgjithshme.

Koncepti i fushatës jo-konkurrente

Para se të shqyrtojmë se cilat rregullime mund të jenë më të përshtatshme në Maqedoninë e Veriut sa i përket fushatave jo-konkurrente, është e rëndësishme të sqarojmë konceptet e përfshira. Me fushatë jo-konkurrente nënkuptojmë aktivitetet e çdo personi fizik ose juridik që nuk është parti politike (ose ndonjë subjekti tjetër që ka nominuar kandidatë për zgjedhje), dhe as kandidat, të cilat kanë për qëllim të ndikojnë në mënyrën se si zgjedhësit votojnë në zgjedhje. Ekzistojnë dy aspekte kryesore:

Aktivitetet e ndërmarra mund të konsiderohen fushatë jo-konkurrente, nëse përfshijnë shpenzime dhe nëse synojnë ose mund të vlerësohen se kanë efektin e ndikimit në mënyrën se si zgjedhësit votojnë.

Aktorët mund të konsiderohen si pjesëmarrës në fushatë jo-konkurrente nëse kryejnë aktivitetet e përshkruara më lart. Rezoluta e Kombeve të Bashkuara e diskutuar më poshtë vetëm i inkurajon vendet të marrin në konsideratë rregullimin e fushatës nga "personat juridikë dhe marrëveshjet ligjore". Megjithatë, në rregulloret e përdorura në vendet rëndësishme (shih faqen 5), edhe personat privatë mund të konsiderohen si pjesëmarrës në fushatë jo-konkurrente në situata të caktuara.

Në diskutim mbi fushatat e jo-konkurrentëve, është thelbësore të përcaktohet se çfarë nuk përfshihet në këtë koncept. Tabela 1 më poshtë paraqet aktivitetet që zakonisht kryhen lidhur me fushatat zgjedhore dhe që nuk konsiderohen pjesë e fushatës jo-konkurrente.

Tabela 1: Aktivitetet që nuk përfshihen në konceptin e fushatës jo-konkurrente

Aktiviteti	Sqarimi
Aktivitetet financiare nga subjektet që janë formalisht të lidhura me një parti politike	Subjekte që janë të lidhura formalisht me një parti politike, siç është forumi i grave ose të rinjve të një partie, ose një grup ekspertësh i lidhur formalisht (think-tank), nuk konsiderohen pjesëmarrës në fushatë jo-konkurrente. Institucionet e tilla si Këshilli i Evropës rekomandojnë që transaksionet e tyre financiare të përfshihen në raportimin financiar nga partia e lidhur politike. ²
Aktivitetet financiare nga subjektet që janë formalisht të lidhura me një kandidat	Aktivitetet e atyre që janë të lidhura formalisht me një kandidat, siç janë përfaqësuesit e caktuar financiarë ose menaxherët e fushatës, (normalisht) konsiderohen pjesë e fushatës zgjedhore të kandidatit dhe transaksionet e tyre financiare duhet të përfshihen në raportimin e kandidatit. ³
Bërja e donacioneve në emër të dikujt tjetër, ose bërja e	Bërja e donacioneve përmes një ndërmjetësi, ose veprimi si ndërmjetës në procesin e dhënies së donacioneve, mund të shkelë ligjin, por nuk konsiderohet fushatë jo-konkurrente

² Këshilli i Evropës (2003) Neni 11.

³ Anëtarët e familjes ose miqtë e një kandidati mund të shihen, megjithatë, si duke kryer *fushatë nga jo-konkurrentët*. Kjo lidhet ngushtë me çështjen e koordinimit – shih më tej faqen 10.

Aktiviteti	Sqarimi
donacioneve duke përdorur dikë tjetër si ndërmjetës	
Mbledhja e fondeve në mënyrë të veçantë nga një parti politike ose kandidat, të cilat më pas i jepen një partie ose kandidati, nuk përbën pjesë të fushatës jo-konkurrente.	Çdo donacion i bërë ndaj një partie ose kandidati përcaktohet këtu si të ardhura të atij konkurrenti, pavarësisht nga mënyra se si janë mbledhur fondet.
Shprehja e mbështetjes për një konkurrent, e cila nuk përfshin shpenzime financiare, nuk përbën pjesë të fushatës jo-konkurrente.	Për shembull, publikimi në rrjetet sociale në favor ose kundër një konkurrenti nuk përbën fushatë nga jo-konkurrentët (për sa kohë personi nuk paguhet për ta bërë këtë). ⁴
Fushata për një çështje, kur kjo nuk përbën mbështetje të tërthortë ose cenim të ndonjë konkurrenti, nuk konsiderohet pjesë e fushatës së jo-konkurrentëve.	Aktivitetet, edhe nëse përfshijnë shpenzime, ku shprehet një qëndrim për një çështje të caktuar, për sa kohë që nuk bëhen thirrje në favor ose kundër një konkurrenti të caktuar, nuk konsiderohet si fushatë e jo-konkurrentëve. ⁵

Standardet mbi fushatën jo-konkurrente në Evropë

Një pikënisje e rëndësishme për shqyrtimin e rregullimit të fushatës së jo-konkurrentëve në Maqedoninë e Veriut janë standardet ekzistuese globale dhe rajonale. Fatkeqësisht, kjo çështje trajtohet shumë pak në dokumentet globale apo rajonale mbi financimin politik. Në dhjetor 2025, Konferenca e Shteteve Palë në kuadër të Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit (UNCAC) miratoi një rezolutë të titulluar “Parandalimi dhe luftimi i korrupsionit përmes rritjes së transparencës në financimin e partive politike, kandidaturave për funksione publike të zgjedhura dhe fushatave zgjedhore. Ky është dokumenti më i detajuar i standardeve globale mbi financimin politik i miratuar deri më sot dhe, për qëllimet e këtij raporti, veçanërisht i rëndësishëm është ai që quhet “paragrafi operativ 9(n)”:

“Inkurajon Shtetet Palë që, në përputhje me legjislacionin e tyre të brendshëm, të shqyrtojnë masa për rregullimin e subjekteve juridike dhe marrëveshjeve ligjore që financojnë aktivitete komunikimi me qëllim arritjen e rezultateve të caktuara zgjedhore, si dhe të kërkojnë nga këto subjekte të bëjnë publike informacionin identifikues mbi sponsorët e këtyre aktiviteteve”⁶

Ky formulim, edhe pse mjaft kompleks, përmban dy pika kryesore: E para është një thirrje më e përgjithshme drejtuar Shteteve Palë për të shqyrtuar rregullimin e aktiviteteve të atyre që zhvillojnë fushata zgjedhore pa qenë parti politike apo kandidatë. E dyta është referencë më specifike ndaj detyrimeve për raportim nga ana e këtyre fushatave lidhur me subjektet që i financojnë aktivitetet e tyre.

⁴ Megjithatë, fushata nga jo-konkurrentët mund të jetë e rëndësishme në publikimet në mediat sociale në rast se kjo bëhet përmes botëve me pagesë, si dhe pagesave për influencersit (në rastin e fundit, jo-konkurrenti në fushatë do të ishte personi ose subjekti i cili e bën pagesën për influencersin).

⁵ Shih më tej f. 11.

⁶ UNCAC (2025).

Duke qenë se kjo rezolutë është shumë e re, mbetet për t'u parë se çfarë ndikimi do të ketë ajo në rregulloret mbi financimin politik në vendet e ndryshme të botës, përfshirë edhe Ballkanin Perëndimor.

Udhëzimet e përbashkëta të OSCE/ODIHR dhe Komisioni i Venedikut mbi rregullimin e partive politike i referohen gjithashtu fushatës së zhvilluar nga aktorë jo-konkurrentë. Udhëzimet theksojnë se shpenzimet si pjesë e një fushate të tillë "...nuk duhet të ndalohen, por mund t'i nënshtrohen kufizimeve të arsyeshme dhe proporcionale".⁷ Po ashtu, ato vënë në dukje se përfshirja e aktorëve jo-konkurrentë në fushatë "...mund të krijojë boshllëk në fushën e financimit politik dhe zgjedhor", ndërsa theksojnë se "...masat e ndërmarra për të rregulluar përfshirjen e palëve të treta duhet të jenë të nevojshme dhe proporcionale".⁸

Duke hyrë më tej në detaje, Udhëzimet theksojnë se:

"...një kufi për donacione ndaj partive politike ka gjasa të mos jetë efektiv nëse, në të njëjtën kohë, grupe të tjera, siç janë grupet e interesit ose grupet mbështetëse, sindikatat dhe shoqatat mund të shpenzojnë shuma të pakufizuara parash për të mbështetur ose kundërshtuar një parti politike a kandidat të caktuar. Që të shmangët krijimi i boshllëqeve përmes të cilave mund të kanalizohet financimi i pakufizuar dhe të maskohen transaksionet financiare, ligjet duhet të vendosin kufizime proporcionale dhe të arsyeshme për shumën të cilën palët e treta mund ta shpenzojnë për promovimin e kandidatëve apo partive, në mënyrë ideale duke zbatuar kufijtë ekzistues për donacionet ndaj partive politike edhe për këta aktorë, si dhe..."⁹

Bashkimi Evropian tradicionalisht ka zgjedhur të mos nxjerrë standarde apo rregullore lidhur me financimin e partive politike apo të fushatave zgjedhore.¹⁰ Një ndryshim i pjesshëm i kësaj qasjeje ndodhi në vitin 2024, me miratimin e "Rregullores (EU) 2024/900 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 13 marsit 2024 mbi transparencën dhe targetimin e reklamimit politik".¹¹ Kjo rregullore nuk e trajton drejtpërdrejt konceptin e fushatës së aktorëve jo-konkurrentë si të tillë, por, duke qenë se fokusohet në aktivitetin e reklamimit politik, pavarësisht se kush e porosit apo e financon atë, dispozitat e saj zbatohen edhe për aktivitetet e fushatës, duke përfshirë reklamimin nga aktorë jo-konkurrentë.¹² Rregullorja përcakton se çdo reklamë politike duhet të jetë e etiketuar qartësisht dhe duhet të përfshijë informacion rreth asaj se kush ka bërë pagesën për të.¹³ Ndonëse në Rregullore nuk përkrahë detyrimi i raportimit financiar të atyre që blejnë apo shesin reklama politike, në të përkrahë krijimi i një regjistri të reklamave politike nga Komisioni Evropian.¹⁴ Së fundi, Rregullorja

⁷ ODIHR dhe Komisioni i Venedikut (2020) neni 218. Versioni origjinal i Udhëzimeve nga viti 2010 gjithashtu i referohej fushatës së jo-konkurrentëve, duke e bërë atë një nga dokumentet e para standarde që e bëri këtë. ODIHR dhe Komisioni i Venedikut (2010) neni 205.

⁸ ODIHR dhe Komisioni i Venedikut (2020) neni 219.

⁹ ODIHR dhe Komisioni i Venedikut (2020) neni 220. Megjithatë, udhëzimet theksojnë se "...këto kufizime duhet të zbatohen vetëm në rastet kur palët e treta dhe veprimet e tyre kanë për qëllim të përfitojnë parti të caktuara politike, qoftë në përgjithësi ose gjatë fushatave. Kjo nuk duhet t'i pengojë OJQ-të dhe grupet e tjera të interesit të debatojnë çështje me interes publik gjatë fushatave, pa dëmtuar fushën e barabartë të lojës për konkurrentët në zgjedhje." ODIHR & Komisioni i Venedikut (2020) Neni 221.

¹⁰ Jashtë financimit të "partive politike evropiane", të përbëra nga parti politike nga shtetet anëtare të BE-së. Shih Parlamentin Evropian (2014).

¹¹ Parlamenti Evropian (2024). Rregullorja hyri në fuqi në tetor 2025.

¹² Rregullorja e përcakton reklamimin politik si mesazhe të postuara "...nga, për ose në emër të një aktori politik..." Po aty, neni 3.2.a.

¹³ Po aty neni 11.

¹⁴ Po aty neni 13.

përfshin një kufizim indirekt mbi atë se kush mund të zhvillojë fushata zgjedhore në shtetet anëtare të BE-së, përmes dispozitës sipas së cilës ofruesit e reklamimit duhet t'i refuzojnë reklamat nga subjektet jashtë BE-së gjatë tre muajve të fundit para zgjedhjeve.¹⁵

Po ndalimi i plotë i fushatës prej aktorëve jo-konkurrentë? Dispozita në Udhëzimet e OSBE/ODIHR-it dhe Komisionit të Venedikut që fushata e jo-konkurrentëve nuk mund të ndalohet bazohet në vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, të cilat interpretojnë Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.¹⁶ Konventa nuk i referohet në mënyrë të drejtpërdrejtë fushatës së aktorëve jo-konkurrentë; ajo thekson rëndësinë e zgjedhjeve që do tëmbahen "...në kushte që sigurojnë shprehjen e lirë të mendimit të popullit në përzgjedhjen e legjislaturës". Megjithatë, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, përmes disa vendimeve, ka treguar se kufizimet e konsiderueshme ndaj fushatës së aktorëve jo-konkurrentë mund të përbëjnë shkelje të nenit 10 të Konventës, i cili garanton lirinë e fjalës.¹⁷ Përfundimisht, kjo nënkupton se çdo ndalim i përgjithshëm i fushatës së aktorëve jo-konkurrentë në një vend evropian ka shumë gjasa të rrëzohet nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, nëse një çështje e tillë do të paraqitej para saj. Rekomandohet që Maqedonia e Veriut të mos shqyrtojë vendosjen e një ndalimi të plotë të fushatës së zhvilluar prej aktorëve jo-konkurrentë.¹⁸

Përvojat krahasimtare

Që nga fillimi i vitit 2026, vetëm katërmbëdhjetë vende në nivel global rezultojnë se kanë dispozita ligjore lidhur me zhvillimin e fushatave të aktorëve jo-konkurrentë (duke përjashtuar ndalimet e plota). Më shumë se gjysma e këtyre vendeve ndodhen në Evropë, ndërsa shumica e të tjerave janë demokraci më të vjetra në Amerikën e Veriut ose Oqeani, me përjashtim të dy shembujve në Afrikë. Maqedonia e Veriut nuk duhet të kopjojë rregulloret e asnjë vendi tjetër, por mund të mësojë nga përvojat e shteteve që tashmë e kanë rregulluar këtë çështje. Tabela 2 më poshtë paraqet vendet që përdorin rregullore për fushatën e aktorëve jo-konkurrentë, duke theksuar llojet e rregulloreve të përdorura në secilin rast.

Tabela 2. Vendet me rregullore për fushatën e aktorëve jo-konkurrentë

Vendi	Komenti	Përmbledhja e rregulloreve
Australia	Bën dallimin midis "palëve të treta" dhe "palëve të treta të rëndësishme", varësisht nga niveli i shpenzimeve.	Kërkesa për regjistrim nëse është mbi pragun e shpenzimeve, ndalimi i donacioneve të huaja, kërkesat për raportim
Kanada	Përkufizohet si "një person ose grup që dëshiron të marrë pjesë ose të ndikojë në zgjedhje përveç se si parti	Kërkesa për regjistrim nëse është mbi pragun e shpenzimeve, ndalimi i donacioneve të huaja dhe anonime, kufiri i shpenzimeve dhe kërkesat për raportim

¹⁵ Po aty neni 5.

¹⁶ Këshilli i Evropës (1950).

¹⁷ Shih në veçanti rastin Bowman kundër Mbretërisë së Bashkuar, me informacion shtesë në vendimet për Kwicień kundër Polonisë dhe Kita kundër Polonisë. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (1998), Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (2007) dhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (2008).

¹⁸ Në raportin përfundimtar të vëzhgimit për zgjedhjet presidenciale të vitit 2024 në Sllovaki, OSBE/ODIHR theksoi se "...ndalimi i financimit nga palët e treta është kufizues dhe joefektiv, në praktikë nuk i ndalon, por i shtyn aktivitetet e palëve të treta jashtë rregullores. Siç është vërejtur edhe në raportet e mëparshme të ODIHR-it, ndalimi i plotë i financimit të palëve të treta nuk është në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (ECtHR) dhe me praktikën e mirë zgjedhore. KSHZ-ja ka rekomanduar në të kaluarën që mundësia e fushatës së rregulluar nga palët e treta duhet të rivendoset në ligj". OSBE/ODIHR (2024a) faqe 10.

Vendi	Komenti	Përmbledhja e rregulloreve
	politike, shoqatë e njësisë zgjedhore, konkurrent ose kandidat i nominuar	
Republika Çeke	VETËM nëse bën fushatë pa dijeninë e konkurrentit	Kërkesa për regjistrim, limit shpenzimesh, kërkesë për raportim
Gjermania	Dispozitat e vëna në v, 2024 - cilido që dëshiron të nxjerrë reklama mbështetëse të partisë duhet ta informojë partinë paraprakisht	Nuk ka kërkesë për regjistrim, limit shpenzimesh ose kërkesë për raportim, por nxjerrja e reklamave të padeklaruara në zgjedhje mund të sjellë gjobë deri në 100,000 euro
Irlanda	Përkufizimi i lidhur me marrjen e donacioneve për qëllime politike	Kërkesa për regjistrim nëse të ardhurat janë mbi pragun, ndalimi i donacioneve të huaja dhe kufizimi i donacioneve anonime, kërkesat për raportim
Kenia	Partia ose kandidati që mbështetet duhet të miratojë fushatën	Kërkesa për regjistrim, kufizimi i shpenzimeve, kërkesa për raportim
Letonia	Për subjektet që nuk konsiderohen të lidhura administrativisht me partitë	Limiti i shpenzimeve, kërkesa për raportim
Monako	Zbatohet për të gjithë ata që kanë "shpenzime zgjedhore"	Raportimi mund të kërkohej nga institucioni mbikëqyrës
Mali i Zi	Dispozitat e futura në korrik 2025	Limiti i shpenzimeve, kërkesa për raportim
Zelanda e Re	Termi i përdorur është "promovuesi i palës së tretë"	Kërkesa për raportim nëse shpenzimet janë mbi pragun
Zvicra	Dispozitat e futura në vitet 2022-2023	Kërkesa për raportim nëse shpenzimet janë mbi pragun
Tanzania	OSHC-të, organizatat e komunitetit dhe ato fetare që bëjnë fushatë	Kërkesa për raportim
Mbretëria e Bashkuar	„individë dhe organizata që ‘...bëjnë fushatë në favor ose kundër partive politike apo kandidatëve, ose mbi çështje që lidhen me zgjedhjet, pa paraqitur vetë kandidatë “	Regjistrimi nuk kërkohej, por lejon një limit më të lartë shpenzimesh, kufizime për donacione të njëjta si për garuesit, limiti i shpenzimeve dhe kërkesa për raportim
Shtetet e Bashkuara	Termi i zakonshëm është "komitetet e veprimit politik“	Rregullat varen nga lloji i subjektit, megjithëse ekzistojnë kërkesa për raportim

Nga vendet e përfshira në Tabelën 2, do t'i kushtohet vëmendje e veçantë rasteve të Irlandës dhe Mbretërisë së Bashkuar, meqë sistemet e tyre rregullatore në këtë fushë janë më të hollësishme dhe kanë qenë në fuqi për një periudhë më të gjatë kohore.¹⁹ Po ashtu, do t'i kushtohet vëmendje edhe Malit të Zi, ku, megjithëse, rregulloret për fushatën e aktorëve jo-konkurrentë janë relativisht të kufizuara dhe së fundmi të vendosura, në vazhdim e sipër është puna për hartimin e procedurave të mbikëqyrjes dhe udhëzimeve për palët e interesuara. Rregullat e reja të prezantuara në Malin e Zi mund të jenë veçanërisht të rëndësishme për hartimin e rekomandimeve për Maqedoninë e Veriut.

¹⁹ Në të kundërtën, dispozitat në Gjermani, Monako dhe Zvicër në veçanti janë veçanërisht të kufizuara ose janë futur së fundmi, që do të thotë se ka informacion të kufizuar në dispozicion në lidhje me zbatimin ose ndikimin e tyre..

Mbretëria e Bashkuar

Në Mbretërinë e Bashkuar, fushatat jo-konkurrente kanë qenë pjesë e skenës zgjedhore për të paktën 75 vjet, duke përfshirë veçanërisht subjekte brenda lëvizjes sindikale që kanë bërë fushata në favor të Partisë Laburiste, ndërsa subjektet korporative kanë bërë fushata kundër asaj partie (ose të paktën kundër politikave që ajo ka propozuar).²⁰

Fushatat jo-konkurrente u trajtuan në raportin zyrtar të Komitetit të Neillit në vitin 1998, ku u deklarua:

“Natyrishë se nuk ka asgjë të keqe që të angazhohen individët dhe organizatat në aktivitetet e këtilla. Përkundrazi, një shoqëri e lirë kërkon që ata të jenë të lirë të bëjnë këtë, madje duhet të inkurajohen që ta bëjnë, por, në kontekstin e fushatave zgjedhore, duke vepruar kështu, ata duhet të jenë subjekt i kufizimeve të njëjta të shpenzimeve si partitë vetë.”²¹

Çështja u rregullua më pas në nivel kombëtar përmes Ligjit mbi Partitë Politike, Zgjedhjet dhe Referendumet të vitit 2000 (PPERA). Ka pasur disa ndryshime ligjore më vonë, veçanërisht në vitin 2009 dhe 2014.

Në Mbretërinë e Bashkuar, një fushatë nga një person ose organizatë që nuk është pjesë e garës gjatë një fushate të përgjithshme zgjedhore është një individ ose organizatë që kryen shpenzime që mund “...të konsiderohen me arsye se synojnë për të promovuar ose siguruar sukses zgjedhor në çdo zgjedhje për...” një parti politike ose një kandidat.²²

Çelësi i sistemit britanik është „testi i qëllimit“ që Komisioni Zgjedhor kryen për të vendosur nëse „...një aktivitet mund të konsiderohet arsyetueshëm si synim për të ndikuar votuesit të votojnë në një mënyrë të caktuar “.²³ Ky test aplikohet në kategori të ndryshme aktivitetesh dhe përfshin shqyrtimin e këtyre faktorëve kryesorë:

1. Thirrja për veprim
2. Toni
3. Konteksti dhe koha
4. Si do e perceptonte aktivitetin një person i arsyeshëm²⁴

Pjesëmarrësit në fushatë që nuk janë konkurrentë duhet të regjistrohen në Komisionin Zgjedhor nëse gjatë vitit para zgjedhjeve planifikojnë të shpenzojnë më shumë se 10,000 paund (rreth 11,500 euro). Shuma maksimale që një jo-konkurrues lejohet të shpenzojë në një fushatë kombëtare është 702,130 paund (rreth 800,000 euro). Kjo përbën rreth 0.15 euro për person me të drejtë vote, duke u bazuar në vitin 2024.²⁵

Jo-konkurrentët e regjistruar duhet të dorëzojnë raporte financiare mbi të ardhurat dhe shpenzimet e tyre pranë Komisionit Zgjedhor, i cili i publikon këto raporte në faqen e tij zyrtare.

²⁰ Hodgson of Astley Abbots (2016) f. 9.

²¹ Cituar py aty f. 10.

²² Mbretëria e Bashkuar (2000) neni 85.2.b.

²³ Komisioni Zgjedhor i Mbretërisë së Bashkuar (2025a).

²⁴ Komisioni Zgjedhor i Mbretërisë së Bashkuar (2025b).

²⁵ Popullsia me të drejtë vote sipas të dhënave të International IDEA (2025). Kufiri i shpenzimeve për jo-konkurrentët e fushatës lidhet me kufirin për partitë politike, dhe niveli aktual u prezantua në vitin 2023, duke qenë pothuajse dyfishimi i kufirit që ekzistonte më parë. Ky kufi aplikohet gjithashtu edhe për shpenzimet për hulumtime të tregut që synojnë të marrin opinionet e anëtarëve të publikut.

Duhet të theksohet se aktorët në fushatë jo-konkurrense përfshihen nga ndalimi i reklamimit politik që zbatohet në Mbretërinë e Bashkuar para zgjedhjeve. Përdorimi i këtij ndalimi për subjekte të tjera përveç partive politike u shqyrtua nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në vitin 2013, e cila vendosi se ky ndalim nuk përbënte shkelje të Lirisë së Shprehjes.²⁶

Në zgjedhjet e fundit kombëtare të vitin 2024, aktori që mori pjesë në fushatë jo-konkurrense dhe shpenzoi shumë të madhe parash ishte sindikata Lidhja Kombëtare e Arsimit, e cila shpenzoi 618,000 paund (rreth 710,000 euro); kjo sindikatë gjithashtu shpenzoi shumë më të madhe midis jo-konkurrentëve të tillë në fushatën e vitit 2019. Shumica e jo-konkurrentëve të tjerë që shpenzuan shuma të mëdha në dy zgjedhjet më të fundit ishin ose sindikatat ose iniciativat e shoqërisë civile me orientim të majtë.²⁷ Megjithatë kategoritë e shpenzimeve të përdorura për raportimin financiar nuk lejojnë një analizë të detajuar, duket se reklamimi onlajn ka konsiderohej si një nga kategoritë kryesore të shpenzimeve.²⁸

Në vitin 2025, kishte 56 aktorë në fushatë jo-konkurrense në Mbretërinë e Bashkuar (një rënie nga 61 në zgjedhjet e vitit 2019). Pjesa e tyre e shpenzimeve totale të fushatës raportohet se ka rënë nga rreth 9% në zgjedhjet e vitit 2019 në rreth 3% në zgjedhjet e vitit 2024 (duke e bërë shpenzimin e vitit 2024 të ngjashëm me atë të zgjedhjeve paraprake).²⁹

Përvoja e Mbretërisë së Bashkuar tregon se si fushatat nga individë ose organizata që nuk janë pjesë e garës zgjedhore mund të rregullohen për të rritur transparencën në financimin e fushatave zgjedhore në përgjithësi. Deri më tani, duke pasur parasysh nivelin e ulët të shpenzimeve të këtyre zhvilluesve të fushatave krahasuar me shpenzimet e partive politike dhe kandidatëve, mund të diskutohet nëse rritja e *de fakto* e transparencës përmes këtyre rregullave justifikon ngarkesën e punës që sistemi i krijon Komisionit Zgjedhor dhe subjekteve të tjera, përfshirë vetë zhvilluesit e fushatës që nuk janë pjesë e garës zgjedhore.³⁰

Irlanda

Fushatë jo-konkurrense është rregulluar në Irlandë qysh në vitin 2001.³¹ Në sistemin irlandez, një pjesëmarrës në fushatë që nuk është pjesë e garës zgjedhore përkufizohet si një individ ose grup që pranon një donacion mbi 100 euro brenda një viti kalendarik. Pasi kjo ndodh, jo-konkurrenti duhet të njoftojë Komisionin për Standardet në Funkcionet Publike (SIPOC) për një person përgjegjës. Nëse pala e tretë është aktive në pjesë të caktuara të vendit, ajo gjithashtu do të jetë e detyruar të regjistrohet pranë institucioneve të tjera përkatëse.³²

²⁶ Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (2013). Megjithatë, mund të jetë e vlefshme të përmendet se ky ishte një vendim i nëntë kundër tetë gjykatësve, ku pakica vendosi që ndalimi përbënte një shkelje të tillë.

²⁷ Analizuar nga „Power” (2025). Përfshirimi kryesor ishte një biznesmen i cili, si një aktivist jo-konkurrent, shpenzoi 484,000 £ (rreth 560,000 EUR) në zgjedhjet e vitit 2019. Ndërsa disa nga këto grupe morën të ardhura nga një gamë e gjerë mbështetësish, kishte edhe mbështetës. Një kërkim i të dhënave zyrtare të donacioneve të vitit 2024 tregon se shpenzuesi i dytë më i madh, një fushatë e shoqërisë civile skeptike ndaj -Brexit, mori pjesën më të madhe të donacioneve të saj nga dy individë (njëri një biznesmen filantrop i cili gjithashtu ka mbështetur financiarisht partitë politike me prirje të majta, dhe tjetri një anëtar i bordit të së njëjtës organizatë).

²⁸ Po aty.

²⁹ Power (2025).

³⁰ Kjo mund të krahasohet me situatën në SHBA, ku në zgjedhjet e vitit 2024, shpenzimet nga jo-konkurrentët për fushatën tejkaluan shumë e shpenzuar nga kandidatët në mbi 10% të garave për Kongresin. Ohman (2026 në vijim).

³¹ Ohman (2020) f. 29.

³² Shih për shembull Këshillin e Qarkut të Roskomonit (pa datë).

Pjesëmarrësit e fushatave të cilët nuk garojnë për zgjedhje në Irlandë përgjithësisht nuk janë të detyruar të raportojnë informacion mbi donacionet individuale të marra ose shpenzimet e kryera.³³ Në nivel kombëtar, palët e treta duhet të dorëzojnë raporte vjetore pranë SIPOC, duke certifikuar se të gjithë donacionet janë depozituar në llogarinë e tyre të bankës së caktuar.³⁴ Megjithatë, për zgjedhjet presidenciale, palët e treta duhet të dorëzojnë deklarata për donacionet dhe shpenzimet e zgjedhjeve brenda 56 ditëve nga dita e zgjedhjeve, duke përfshirë detaje të të gjitha donacioneve që tejkalojnë 600 euro.³⁵ Për më tepër, në përputhje me legjislacionin e veçantë për zgjedhjet lokale, palët e treta që janë aktive në zgjedhjet lokale duhet të dorëzojnë raporte financiare mbi donacionet e marra pranë qarkut lokal përkatës.³⁶ Rëndësishëm, SIPOC nuk është e detyruar të publikojë raportet financiare të dorëzuara nga pjesëmarrësit e fushatave që nuk janë pjesë e garës.³⁷

Ekzistojnë disa kufizime mbi donacionet që mund të pranojnë jo-konkurrentët, siç janë: ndalimi i donacioneve nga burime të huaja ose në kriptomonedha, donacione anonime mbi 100 euro dhe donacione në para të gatshme mbi 200 euro, si dhe ata nuk mund të marrin më shumë se 2,500 euro nga i njëjti dhurues brenda një viti kalendarik.³⁸

Ndryshe nga Mbretëria e Bashkuar, palët e treta irlandeze (si dhe konkurrentët) lejohen të kryejnë reklamim, me kusht që „...t'i paraqesin botuesit një Certifikatë Autorizimi nga Komisioni për Standarde që konfirmon se kanë përmbushur detyrimet e tyre ligjore “.³⁹

Ka pasur disa shqetësime se rregulloret irlandeze për fushatat e jo-konkurrentëve mund të kenë një ndikim negativ mbi lirinë e fjalës. Kjo lidhet veçanërisht me rregullimin mbi fushatat për „qëllime politike“, të cilin mbështetësit e shohin si të nevojshëm për të rregulluar përfshirjen e jo-konkurrentëve në fushatat zgjedhore, por të cilin Këshilli Irlandez për Liritë Civile e ka përshkruar me këto terma;

“...formulimi ligjor ndalon çdo grup qytetarësh të mbledhë shuma të konsiderueshme parash për të mbështetur një politikë të caktuar ose për të kritikuar aktivitetet e qeverisë apo të çdo autoriteti publik ose funksionari.

Disa organizata të shoqërisë civile (CSO) në Irlandë tashmë kanë ndjerë efektet e interpretimit të rreptë të Ligjit nga SIPOC. Ndërkohë, meqë Ligji aplikohet vetëm për donacionet, kompanitë dhe individët që mund të përballojnë vetë shpenzimet për lobimin e tyre dhe nuk kanë nevojë të mbledhin mjete financiare, u lejonet të angazhohen në sistemin politik.”⁴⁰

Komisioni Irlandez për të Drejtat e Njeriut dhe Barazinë bëri vërejtje në një raport të vitit 2019 se ishte i nevojshëm një rishikim i Ligjit Zgjedhor për të vendosur

“...një lidhje më të qartë midis kufizimeve të vendosura mbi aktivitetin e ‘palëve të treta’ dhe aktivitetin për ‘qëllime politike’ me çështjet zgjedhore – d.m.th. zgjedhjet dhe referendume –

³³ Komisioni për Standardet në Funksionet Publike (2024a) f. 8.

³⁴ Po aty f. 9.

³⁵ Komisioni për Standardet në Funksionet Publike (2025a) f. 15, 24.

³⁶ Shih për shembull Këshillin e Qarkut Roskomon (pa datë).

³⁷ Komisioni për Standardet në Funksionet Publike (2026).

³⁸ Komisioni për Standardet në Funksionet Publike (2024a) faqet 10-12, Komisioni për Standardet në Funksionet Publike (2025a) f. 41.

³⁹ Komisioni për Standardet në Funksionet Publike (2024b) page 22.

⁴⁰ Këshilli i Irlandës i Lirive Civile (pa datë).

dhe jo me aktivitetet më të gjera të shoqërisë civile që synojnë të ndikojnë në vendimarrjen dhe hartimin e politikave,”⁴¹

Një projektligj i iniciuar nga një deputet individual, i quajtur “Projektligj Zgjedhor (Liria e Shoqërisë Civile) (Ndryshim)”, u paraqit në Parlamentin irlandez në vitin 2019, me qëllim ndryshimin e dispozitave që lidhen me “qëllimet politike”.⁴² Megjithatë, ky projektligj ende nuk është votuar.

Në vitin 2024, në Irlandë, ishin të regjistruar 27 pjesëmarrës në fushatë të cilët nuk ishin konkurrentë.⁴³ Një artikull i publikuar atë vit theksonte se palët e treta deri më tani nuk kanë qenë shumë të përfshira në fushatat zgjedhore në Irlandë, po megjithatë potencohet se, nëse kjo ndryshon në të ardhmen, “...shqetësimet aktuale për shpenzimet për postera dhe pensionistët e pasur britanikë mund të duken të çuditshme”.⁴⁴ Pritet që mandati për mbikëqyrjen e fushatave të jo-konkurrentëve në Irlandë të transferohet tek Komisioni i ri i Pavarur Zgjedhor.

Përvoja irlandeze tregon mundësi interesante në rregullimin e fushatave të jo-konkurrentëve, por edhe boshllëqe të mundshme. Dispozitat që lidhen me “qëllimet politike” duket se kanë shkaktuar shqetësime të konsiderueshme tek aktorët e shoqërisë civile në vend dhe mund të kenë një efekt frenues mbi lirinë e shprehjes së shoqërisë civile në Irlandë. Në të njëjtën kohë, mungesa e dispozitave për publikimin e pasqyrave financiare të jo-konkurrentëve që nuk janë pjesë e garës do të thotë se nuk ka pasur rritje të transparencës publike lidhur me mënyrën se si financohen fushatat zgjedhore në vend.

Mali i Zi

Deri në vitin 2025, asnjë vend në Ballkanin Perëndimor nuk kishte miratuar dispozita ligjore që lidhen me fushatat zgjedhore të jo-konkurrentëve. Megjithatë, ndryshimet e korrikut 2025 në *Ligjin për Financimin e Subjekteve Politike dhe Fushatave Zgjedhore* përfshinë rregullimin e fushatave të jo-konkurrentëve.⁴⁵ Megjithëse këto dispozita ende nuk janë testuar në ndonjë proces zgjedhor, ngjashmëritë ndërmjet Malit të Zi dhe Maqedonisë së Veriut e bëjnë analizën e këtyre dispozitave veçanërisht relevante për ligjvënësit vendorë.

Dispozitat e reja e përkufizojnë një fushatë të jo-konkurrentëve si:

“një aktivitet i paguar, vlera e të cilit tejkalon shumën prej 1,000 euro, i realizuar gjatë fushatës zgjedhore nga një palë e tretë, e cila nuk është e lidhur juridikisht me një subjekt politik, dhe që synon të ndikojë pozitivisht ose negativisht në fushatën zgjedhore të një ose më shumë subjekteve politike.”⁴⁶

Institucionet e kontrolluara nga shteti nuk lejohen të zhvillojnë fushata jo-konkurrençe, ndërsa aktorëve të huaj u ndalohet ta bëjnë këtë në territorin e Malit të Zi. Përndryshe, ligji nuk përcakton qartë se kush mund të zhvillojë një fushatë të tillë, duke nënkuptuar se kjo mund të bëhet nga persona fizikë, persona juridikë ose grupe joformale (apo një kombinim i tyre).

Nuk ekziston një kërkesë e qartë për regjistrimin e fushatave jo-konkurrençe, megjithatë ata janë të detyruar të hapin një llogari të veçantë bankare para se të kryejnë çfarëdo shpenzimi për fushatë dhe

⁴¹ Komisioni Irlandez për të Drejtat e Njeriut dhe Barazinë (2019) f 8.

⁴² Irlanda (2019).

⁴³ Komisioni për Standardet në Funksionet Publike (2025b).

⁴⁴ RTE (2024).

⁴⁵ Teksti i plotë i neneve përkatëse është përfshirë në Shtojcë..

⁴⁶ Mali i Zi (2025) Neni 49, paragrafi 2.

të raportojnë pranë Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit (APC) informacion mbi këtë llogari bankare.

Për fushatat jo-konkurrente obligohet dorëzimi i një raporti të përkohshëm financiar pesë ditë para zgjedhjeve dhe një raport përfundimtar brenda 30 ditëve pas zgjedhjeve. Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APC) ka mandat të publikojë këto raporte në faqen e saj zyrtare.

Jo-konkurruesit kufizohen në shpenzime deri në 10,000 euro për fushatat zgjedhore. Kjo përkthehet në rreth 0.02 euro për person me të drejtë vote sipas vitit 2023. Formulimi i dispozitave ligjore tregon se kjo është shuma maksimale e lejuar edhe për shpenzimet e subjekteve konkurruese, megjithëse në fakt, në një pjesë tjetër të të njëjtit ligj, APC-së i jepet mandati për të përcaktuar kufirin e shpenzimeve për subjektet politike për çdo zgjedhje.⁴⁷

